# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-448820**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimet e qeverisë/ Karakaçi: Rezerva e sigurisë së hidrokarbureve do të menaxhohet nga shteti, nis puna për mbikalimet në Kashar dhe Yrshek |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/ekonomia/vendimet-e-qeverise-ministri-karakaci-rezerva-e-sigurise-se-hidrokarbur-i586451` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 11:05:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d3006bdeb7f911f6ba80787b29768a6979760942f9dcb0edf4fe063c8bdf245a` |
| TEKSTI | `40426dfab22261b35b85d7c68f0ac979212ecebcd7c1959a795a41b77c353084` |
| PAMJA | `35f441570202963daeb7c02c2bddb1af733402f4940dda16fecd028260bcd6b1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ed9f97eda6fc7f1b196a7b67ddbe510707c0761f1df9f5ee244c8c70640f1818` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ed9f97eda6fc7f1b196a7b67ddbe510707c0761f1df9f5ee244c8c70640f1818`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

Të fundit Ministria e Arsimit: Regjistrimet për programin "Pas Shkolle" të hapura deri më 25 shtator përmes sistemit SMIPPisa: mësuesi, nxënësi dhe inteligjenca artificialeFOTO!

# Vendimet e qeverisë/ Karakaçi: Rezerva e sigurisë së hidrokarbureve do të menaxhohet nga shteti, nis puna për mbikalimet në Kashar dhe Yrshek

16 Shtator 2026, 13:40Ekonomia TEMA



Pas mbledhjes së sotme të qeverisë, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, u ndal në disa nga çështjet kryesore të vendimmarrjes ekzekutive dhe zhvillimeve aktuale.

Gjatë këtij prononcimi për mediat, ai bëri me dije miratimin e ligjit të ri për rezervën e sigurisë së hidrokarbureve, e cila do të menaxhohet nga shteti për të garantuar stabilitet në kushtet e pasigurisë së tregut.

Gjithashtu, ministri iu përgjigj interesimit të gazetarëve lidhur me shqetësimet e ngritura nga banorët e Kasharit dhe Yrshekut për vonesat në ndërtimin e mbikalimeve përgjatë autostradës, duke kërkuar ndjesë për shqetësimin e krijuar dhe duke garantuar se puna ka nisur për realizimin e tyre sipas kontratës.

**Deklarata:** Propozojmë që rezerva e sigurisë së hidrokarbuereve do të mbahet nga shteti. Kjo është për momente kur ka pasiguri në treg në kushte të veçanta. Ky ligj i ri krijon detyrimin e ruajtjes së rezervës, duke e menaxhuar dhe e hedhur herë pas here në treg për të mos humbur cilësitë ekonomike. Miratuam vendim për Bashkinë e Tiranës, duke zvogëluar zonën për ndërtim, teksa kemi punuar për të mbyllur sa më shpejt procesin e rindërtimit.

**Banorët e zonës së Kasharit dhe Yrshekut kanë paralajmëruar protestë nëse nuk ngrihen mbikalimet. Tenderi ka qenë që deri më 31 korrik duhet të kishin mbaruar punimet. Çfarë do të ndodhe me banorët?**

Për çdo shqetësim që i krijohet banorëve për punë që janë në të mirë të komunitetit, patjetër që mund të kërkoj ndjesë për çdo shqetësim. Është nisur menjëherë puna për dokumentacionin. Mbikalimet do të bëhen me të njëjtin numër që kanë qenë më parë. Prioriteti është vendosja e mbikalimeve në kohën më të shpejtë.

**Nuk mund të rikthehen provizorisht?**

Mbikalimet janë hequr si rrjedhojë e zgjerimit të autostradës. Kontrata është e lidhur dhe do të nisë menjëherë puna. Për çdo detaj tjetër mund të kërkoni dhe të gjejmë një zgjidhje sa më të mirë.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmujorin e parë 2026]

10:47 Ekonomia

I planifikuar për në tetor, shtyhet Censi i bujqësisë, ja kur do të nisë regjistrimi i sektorit bujqësor dhe blegtoral

16:05 Ekonomia

[Bonusi i pensioneve dyfishohet nga 1 janari/ Të ardhurat e pensionistëve shtohen me 800 deri 1800 lekë]

15:45 Ekonomia / 27 komente


Mbrojtja zbulon faturën, 42 mijë euro në gjashtë muaj për çdo ushtarak në Gaza

15:15 Ekonomia / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.